

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË ARKIVIT TË SHETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivit të Shtetit Tiranë, me objekt “Zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare”, për periudhën 01.01.2011 deri 31.12.2012, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 25, datë 31/03/2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 921/11, datë 31.03.2014 Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z. Gjet Ndoj, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi u konstatua një situatë problematike lidhur me evidentimin e aktiveve të qëndrueshme, në përdorim të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe të Degëve Rajonale në varësi të saj. Kështu u konstatua se gjendja kontabël e këtyre aktiveve nuk përputhet me gjendje reale të tyre dhe nuk ka dokumentacion që të tregojë statusin pronësor të ndërtesave ku ushtrohen funksionet e arkivistikës. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Institucioni të ngrejë grup pune për evidentimin e diferencave të konstatuara në librin analitik të ndërtesave (për 12 objekte), duke bërë dhe sistemimet e duhura në kontabilitet.
- Institucioni të marrë masat e duhura dhe të përfundojë hipotekimin e aseteve që rezultojnë të pa hipotekuar, referuar listës nr.1 bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

Brenda 6 mujorit të parë 2014

2. Auditimi konstatoi se megjithë përpjekjet institucioni nuk kish të miratuar Rregulloren e Re të Brendshme duke sjellë kjo probleme në strukturën dhe pagat e miratuara në këtë Institucion. **Për këtë është rekomanduar që:**

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA), të finalizojë përpjekjet për miratimin e Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit, duke siguruar në çdo moment harmonizimin e saj me bazën rregullative të nxjerrë për këtë sektor të rëndësishëm.

Brenda 6 mujorit të parë 2014.

3. Nga auditimi i procedurave të furnizimit me mallra nga kontraktorët, është konstatuar se ka raste që mallrat mbahen në ruajtje në magazinat e furnitorëve për një kohë të papërcaktuar (disa muaj, në ndonjë rast edhe me vite), pa dokumentacionin e duhur, duke e justifikuar veprimin me mungesën e ambienteve për magazinim. Aktualisht një pjesë e këtyre mallrave nuk janë sjellë akoma në Institucion. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr.10296 “Për menaxhimin Financiar” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA) menjëherë të marrë në dorëzim mallrat që mbahen aktualisht në magazinat e furnitorëve dhe të pasqyrohet në kontabilitet gjendja faktike e këtyre mallrave.
- Të prokurojë mallra në përputhje me nevojat, të krijojë ambientet e duhura dhe të përshtatëshme për magazinimin e tyre, dhe të lidh kontrata për furnizime periodike, në

përputhje me kërkesat e institucionit, si një obsion i parashikuar në bazen ligjore të Prokurimit Publik të mallrave.

Brenda muajit prill 2014

4. Institucioni të kryejë shpërndarjen e artikujve si dosje kartoni e shtypshkrime të ndryshme që qëndrojnë në magazinat e DPA në ASHQ Vendore në sasi të konsiderueshme, sipas një plani shpërndarje të argumentuar sipas nevojave reale dhe kërkesave të degëve rajonale dhe për një periudhë kohe pa afat të mos kryejë blerje të tjera.

Brenda muajit maj 2014

5. Auditimi konstatoi një gjendje të rëndë të ambienteve të magazinave të institucionit, situatë që ka sjellë problematika edhe në mënyrën e administrimit të mallrave që duhet të ruhen në këto ambiente. Duke pasur parasysh vlerat e konsiderueshme të investuara në mallra që i shërbejnë ruajtjes dhe mbajtjes së materialeve arkivore. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Institucioni të planifikojë në mënyrë të kujdesshme investimet e vitit duke i orientuar në drejtim të krijimit të kushteve optimale të magazinave të institucionit pasi janë plotësisht të amortizuara dhe me lagështirë
- Të ngrejë një grup pune për të vlerësuar kushtet e ruajtjes dhe mbajtjes së materialit arkivor në drejtoritë rajonale për të planifikuar sa më drejtë nevojën për investime në krijimin e kushteve optimale të kushteve në ambientet arkivore.

Sipas planit të investimeve

6. Auditimi i procedurave të prokurimit kanë rezultuar mangësi në mënyrën e përcaktimit të kërkesave specifike të shërbimit apo mallit të prokuruar dhe llogaritjes së vlerës së kontratës. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA) të zbatojë me korrektësi kërkesat ligjore të prokurimit, mbi përcaktimin e kriteve specifike, llogaritjen e vlerës së kontratës, duke përgatitur në çdo rast dokumentacionin argumentues, për të analizuar koston e mallrave e shërbimeve.

Vazhdimisht

7. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA) të marrë masa, që në përbërjen e NJHD, KVO dhe Grupeve të kolaudimit e marrjes në dorëzim të mallrave e punimeve, të vendosen specialistë të fushës përkatëse, të vlerësohet pjesëmarrja e ekonomistëve në këto hallka për të rritur eficientësinë e përdorimit të burimeve njerëzore në funksion të mirëpërdorimit të fondeve publike në dispozicion.

Vazhdimisht

8. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA) të marrë masat e duhura që, shpenzimet për blerjen e biletave të udhëtimit jashtë shtetit, shërbimet për automjeteve të kryen sipas rregullave të prokurimit, në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Kreu VI, pika 2, germa “a”, pa pjesëtuar vlerën e kontratës, për të mos shmangur procedurat konkurruese të prokurimit.

Vazhdimisht

9. Të ndërmerren hapat e nevojshëm, për përmbushjen e detyrimeve në përputhje me ligjin për menaxhimin financiar në mënyrë që të evidentohen saktë, të gjitha transaksionet dhe kontabilizimin e tyre duke përcaktuar qartë në rregulloren e brendshme përgjegjësitë e

specialistit dhe të përgjegjësit të zyrës për mbikëqyrjen e regjistrimeve kontabël dhe raportimit financiar.

Vazhdimisht

10. Institucioni të marrë masat për të përdorur programin “Financa 5” ose “Alpha”, në regjistrimin e veprimeve të kontabilitet dhe financës.

Brenda muajit prill 2014

11. Në kuadrin e vlerësimit e përmirësimit të menaxhimit financiar e kontrollit të brendshëm, të merren masa nga titullari, për organizimin e trajnimit brenda institucionit për njohje të legjislacionit dhe akteve nënligjore që kanë dalë për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe funksionet detyruese për zbatimin e tyre sipas hierarkisë në strukturën e DPA.

Vazhdimisht

12. Të merren masa për të hartuar një udhëzim të veçantë, ku të përshtatet zbatimi i ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financës, duke implementuar e përshtatur specifikat dhe veçoritë që ka sektori i Arkivave. DPA të marrë masa organizative për të siguruar niveli e duhur të menaxhimit, duke reflektuar zbatimin e legjislacionit përkatës, kryesisht në administrimin e pronës dhe vlerësimin e riskut sipas periudhave përkatëse të analizës së tyre, kjo në varësi të nevojave që paraqiten në veprime dhe ngjarje ekonomike me risk shpërdorimi.

Brenda 6 mujorit të parë 2014

13. Auditimi konstatoi vënien në dispozicion të ambienteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA) për masterin në arkivistikë të realizuar në bashkëpunim me Fakultetin e Histori Filologjisë të UT, por nuk rezultoi marrëveshje e nënshkruar për këtë bashkëpunim. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të nënshkruaj marrëveshjen e bashkëpunimit, në zbatim të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Brenda muajit prill 2014

14. Institucioni të marrë masat e duhura në lidhje me evidentimin kontabël të diferencave të rezultuara nga inventarizimi i vitit 2012 në magazinën e institucionit në lidhje me artikullin raftë të lëvizshme copë 35 me çmimin 114 999.6 lekë/copë, të identifikojë personat përgjegjës dhe të merren masat e duhura që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

Menjëherë

15. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të ndjekë procedurat gjyqësore në tre shkallët e gjyqimit, ndaj kontraktorëve të parregullt. Për moszbatimin e procedurave, të nxirren përgjegjësitë ndaj personave të ngarkuar me këtë detyrë në Drejtorinë Juridike, duke i trajtuar mosveprimet e tyre, si qëndrime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitet 2011, 2012 dhe 2013.

Vazhdimisht

16. Nga auditimi i dokumentacionit në DPA, mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e kaluara, rezulton se një pjesë e tyre nuk janë zbatuar. **Për këtë është rekomanduar që:**

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të analizojë edhe njëherë materialin e auditimit dhe rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, të ndjekë hapat ligjorë për realizimin e tyre duke vënë para përgjegjesisë personat e ngarkuar nga titullari që nuk kanë vepruar.

Brenda muajit prill 2014

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Nga auditimi i procedurave për objektin “Rikonstruksion i çatisë në AQV Shkodër”, është konstatuar se Autoriteti Kontraktor nuk ka zbatuar VKM nr. 444, date 5.09.1994 “Për tarifën e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit”, lidhur me përllogaritjen e pagesës e mbikëqyrësit të punimeve. Si rezultat, mbikëqyrësi i punimeve për këtë objekt, z. [REDAKTUAR], ka përfituar më tepër se vlera që llogaritet sipas bazës ligjore, **shumën 37.913 lekë (me TVSH)**, e cila përbën dëm ekonomik. **Për këtë është rekomanduar që:**

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të ndjekë procedurat ligjore, për arkëtimin e shumës së mësipërme nga mbikëqyrësi i punimeve.

Menjëherë

2. Nga auditimi në terren mbi zbatimin e kontratës me objekt “Ndërtim, Rikonstruksion, hidroizolim tarrace në AQSH Kukës”, me vlerë 1 562 282 lekë pa TVSH, është konstatuar se nuk janë kryer disa punime, të parashikuara në projekt dhe preventiv. Vlera e këtyre punimeve të pakryera, por të situacionuara dhe bërë pagesa për Kontraktuesin “[REDAKTUAR]” shpk është **701.234 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik. **Për këtë është rekomanduar që:**

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të ndjekë procedurat ligjore, për arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës së mësipërme nga firma “[REDAKTUAR]” shpk.

Menjëherë

3. Institucioni të nxjerrë urdhër zhdëmtimin dhe të ndjekë procedurat ligjore deri në arkëtimin e dëmit nga subjekti “[REDAKTUAR]” shpk për mosfurnizim në kohë në DPA të artikujve

1. Kutit kartoni në sasinë 550 copë me çmimin 468lekë/copë në vlerë **257.400 lekë**,
2. Dosje të thjeshta në sasinë 37000 copë me çmimin 37lekë/copë në vlerë **1.369.000 lekë**,
3. Regjistër korrespondence në sasinë 157 copë me çmimin 332,7 lekë/copë në vlerë **52.233 lekë**.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

D.1. Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në nenin 10, pika a 15 të “Kontratën e punës”, datë 14.09.2012, kërkohet të fillojnë procedurat për dhënie të masës disiplinore: **“Vërejtje me shkrim”, për**

Znj. [REDAKTUAR]

Në cilësinë e anëtares së komisionit të inventarizimit të magazinës, dhe si specialiste që mbulon dhe kuadron magazinën e institucionit, për të dhënat fiktive të rezultuara nga inventarizimi i bërë nga ky komision në vitin 2011 dhe për moskuadrim në kohë të artikujve të magazinës që rezultuan me diferenca.

Menjëherë

Shenim:

Për Z. [REDACTED] ish Drejtori Ekonomik në DPA në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për shkeljet e trajtuara në raportin përfundimtar të auditimit, nuk rekomandoj masë disiplinore, pasi është i larguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Për znj. [REDACTED] ish Drejtore e Drejtorisë Ekonomike dhe ish shefe e financës dhe në cilësinë e kryetares së komisionit të Inventarizimit të asetëve të institucionit në vitin 2012, për shkeljet e trajtuara në raportin përfundimtar të auditimit, nuk rekomandoj masë disiplinore, pasi është e larguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Z. [REDACTED] ish magazinier i institucionit për shkeljet e trajtuara në raportin përfundimtar të auditimit në drejtim të mbajtjes së dokumentacionit të hyrjeve dhe daljeve nga magazina nuk rekomandojmë masë disiplinore, pasi është e larguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

KONTROLI I LARTE I SHTETIT